


KADASTRA



INFRASTRUKTURA KOMBËTARE E INFORMACIONEVE HAPËSINORE






KONCEPTI I INFRASTRUKTURES KOMBËTARE TË INFORMACIONEVE HAPËSINORE

Infrastruktura Kombëtare e Informacioneve Hapësinore (IKIH) është konceptuar si një mënyrë për të rritur qasjen, komunikimin dhe përdorimin e të dhënave gjeohapësinore për të mbështetur një varg të gjerë vendimesh në të gjitha nivelet e shoqërisë. Qëllimi primar i IKIH është zvogëlimi i duplikimit në krijimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave gjeohapësinore, zvogëlimi i kostove për krijimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave gjeohapësinore, përmirësimi i qasjes në të dhënat gjeohapësinore dhe përmirësimi i saktësisë së të dhënave gjeohapësinore të përdorura nga komuniteti i gjerë. Në thelb IKIH mbështetet në një partneritet e bashkëpunim midis agjencive, korporatave, institucioneve dhe niveleve të ndryshme të qeverisjes.

Ky partneritet është i ndërtuar në bazë të përgjegjësi të përbashkëta, kostove të përbashkëta, përfitime të përbashkëta dhe kontrollit të përbashkët dhe për të bërë të mundur që të dhënat e mbledhura nga një agjenci në një nivel të lartë të përdoren nga një agjenci tjetër në një formë më të përgjithësuar. IKIH në thelb nënkupton një seri marrëveshjesh të koordinuara mbi standardet e teknologjisë, aranzhimet institucionale dhe politike që ju mundësojnë përdoruesve kërkimin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor për qëllime të cilat mund të jenë të ndryshme nga synimi i tij origjinal.






INFRASTRUKTURA E INFORMACIONEVE GJEHAPËSINORE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Implementimi i konceptit të IKIH është i një rëndësie të veçantë për Republikën e Kosovës, pasi vendi përditë e më shumë po ballafaqohet me rritje të kërkesës për të dhëna gjeohapësinore, të cilat janë të nevojshme për planifikim dhe vendim-marrje. Sipas Nenit 23 të Ligjit për Kadastër (Ligji Nr 04/L-013), Agjencia Kadastrale e Kosovës është pika qendrore për themelimin dhe koordinimin e IKIH. IKIH në Republikën e Kosovës është duke u implementuar në mënyrë të tillë që aktualisht një kategori e të dhënave hapësinore, respektivisht ato të dhëna të cilat janë ofruar prej institucioneve publike e të cilat deri në një masë plotësojnë kushtet nga pikëpamja e kualitetit e saktësisë, janë duke u ruajtur në nivelin më të përshtatshëm duke bërë të mundur që të njëjtat, në paj

tueshmëri edhe me akte tjera ligjore e standarde teknike, të kombinohen nga burime të ndryshme nga të gjitha institucionet në mënyrë të qëndrueshme. Po ashtu, të njetat të dhëna janë të shkëmbyeshme ndërmjet shumë përdoruesve dhe aplikacioneve, duke mundësuar kështu që të dhënat hapësinore të mbledhura në një nivel të caktuar të autoritetit publik të shkëmbehen ndërmjet autoriteteve të tjera publike.

Deklarata e misionit të IKIH

IKIH ka për qëllim të integrojë gjeoinformacionin nga burime të ndryshme në një infrastrukturë të vetme, të jetë në përputhje me Direktivën INSPIRE, të mbështes qeverisjen elektronike, të shmangë dyfishimin e krijimit të informacioneve hapësinore, të krijojë procese efektive të biznesit, të përmbushë nevojat e palëve të interesuara, të promovojë qasjen, përdorimin dhe shpërndarjen e informacioneve hapësinore.



IMPLEMENTIMI PRAKTIK DHE TË ARRITURAT NË FUSHËN E IKIH

Për të mundësuar implementim praktik të konceptit për IKIH, që nga viti 2012 Agjencia Kadastrale e Kosovës në cilësinë e koordinatores dhe disa institucione tjera publike në cilësinë e palëve të interesit në fushën e IKIH, kanë ndërmarrë veprime konkrete nga aspekti organizativ, ligjor e teknologjik. AKK ka krijuar edhe një strategji për identifikimin e institucioneve publike që prodhojnë, shfrytëzojnë ose mirëmbajnë të dhëna gjeohapësinore si dhe për grumbullim dhe shkëmbim atyre të dhënave. Janë krijuar një numër i ueb shërbimeve për disa produkte gjeohapësinore dhe për një pjesë produktesh janë krijuar edhe meta të dhëna. Po ashtu AKK krijuar edhe Gjeoportalin Shtetëror, një adresë të vetme për grumbullimin, shkëmbimin dhe shpërndarjen e të dhënave gjeohapësinore të cilat janë prodhuara nga institucione publike në Republikën e Kosovës. Aktualisht në Gjeoportal shtetëror ka rreth 85 të dhëna grafike të qasshme si për kërkim po ashtu edhe

shikim të prodhuara nga disa institucione publike, respektivisht nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, Ministria e Bujqësisë, Agjencia e Statistikave e Kosovës, Komisioni për Miniera dhe Minerale, KEK-u etj. Duke marrë parasysh faktin se shumë nga këto shërbime të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, si strategjia për IKIH dhe Gjeoportali shtetëror janë zhvilluar vite më parë dhe të njëjtat tani më nuk i plotësojnë të gjitha nevojat e palëve të interesit në fushën e IKIH, AKK ka paraparë që në kuadër të Projektit për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme në Kadastër dhe për IKIH, huamarrje kjo nga Banka Botërore, të zhvillojë si strategjinë e re po ashtu edhe Gjeoportalin e ri për IKIH. Si përfundim, me angazhimin e AKK dhe me përkrahjen ekspertëve vendor dhe ekspertëve nga shtetet anëtare të BE-së, Republika e Kosovës tani më ka vendosur bazat e implementimit të një infrastrukture moderne gjeohapësinore dhe është duke ndjekur praktikën më të mirë të shteteve të tjera anëtare të Bashkimit Evropian në linjë me Direktivën INSPIRE.

PËRFITIMET NGA IKIH

Informacioni lidhur me hapësirën e lokacionit është me rëndësi pasi që çdo gjë ndodh diku, dhe nëse ne mund të kuptojmë më shumë për natyrën e një lokacioni në Tokë ku ndodhin gjërat, atëherë një IKIH e avancuar mund të na mësojë për ndikimet potenciale mbi njerëzit dhe pasurisë së tyre në atë lokacion. Rrjedhimisht, kjo do të mundësojë planifikimin dhe menaxhimin e mirë të rrezikut, përmes alokimit dhe përdorjes së mirë të burimeve ekzistuese në parandalim të ndikimeve negative që një ngjarje specifike mund të prodhojnë në lokacione specifike. Kjo nënkupton se shkëmbimi i të dhënave rrit cilësinë e jetës për qytetarin ndërsa për institucione lokale dhe qendrore mbështet qeverisjen e mirë për shkak të rritjes së transparencës dhe të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në fusha të interesit të tyre të përditshëm. Për qytetarin, informacioni gjeohapësinor efektiv, i kombinuar me informacione të tjera, mundëson shfrytëzimin e shërbimeve emergjente në mënyrë të shpejtë në vendin e duhur, mundëson mbledhjen e njohurive se ku gjenden shërbimet lokale, mundëson shmangiet shpesh të panevojshme të bllokimeve të komunikacionit e që rezultojn edhe me menaxhimin më të mirë të jetës, pikërisht si rezultat i qasjes në më shumë informacione.




Përfitimet nga IKIH

- Rritet transparenca e qeverisjes dhe vendimmarrjes.
- Përmirëson bashkëpunimin ndërmjet agjencive dhe departamenteve të ndryshme.
- Krijon dhe promovon partneritetin midis sektorit publik dhe atij privat.
- Përmirëson menaxhimin e burimeve natyrore dhe tokësore përveç veprimeve që ndikojnë në komunitet.
- Ndhmon në sigurimin e bazës në mënyrë të qëndrueshme dhe me kosto efektive për programet e monitorimit e ndryshimeve mjedisore, ekonomike dhe sociale. Harmonizon madhësi të shumta të të dhënave hapësinore.
- Avancofrimin e shërbimeve publike, parandolën përhapjen e zjareve, ndihmon në administrimin e trafikut, etj.

IKIH, në favor të stimulimit ekonomik

IKIH mund të jep një stimulim zhvillimit ekonomik përmes përcjellës së zhvillimit të tregut të pronave, mjedisit, bujqësisë, hidrografisë e ngjashëm. E tërë kjo nënkupton se i tërë informacioni gjeohapësinorë mund të luajnë rol kryesorë në zbatimin e një sërë agjendave të politikës publike, brenda tri temave kryesore:

- 1) Nxitjen e efikasitetit të shtuar dhe angazhimin e shoqërisë duke nxitur përdorimin e informacionit gjeohapësinorë në qeveri;
- 2) Mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit në Kosovë përmes njohurive gjeografike, dhe
- 3) Përkrahjen e zhvillimit ekonomik duke njohur peizazhin ekonomik të Kosovës përmes gjeografisë.



PRODUKTET E AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS QË NDIHMojNË IKIH

Pos si implementuese dhe koordinatore e infrastrukturës kombëtare të informacioneve hapësinore në Republikën e Kosovës Agjencia Kadastrale e Kosovë, ashtu sikurse edhe autoritetet homologe të saj nga shtetet e zhvilluara, është edhe një nga prodhueset më të mëdha të produkteve, shërbimeve dhe implementuese e projekteve që ndihmojnë në krijimin e një infrastrukture cilësore e autoritare të informacioneve gjeohapësinore. Duke vepruar në këtë linjë, AKK ka krijuar një varg shërbimesh, produkesh dhe projektsh të cilat poshërbejnë edhe si bazë për implementim të një IKIH sa më cilësore, me më të rëndësishmet mes tyre avancimin e pjesës grafike të Sistemit të Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë, respektivisht krijimin e ueb serviseve për shprërndarjen e informacioneve grafike përmes gjeoportalit e që mundëson që secili qytetar të ketë qasje për kërkim dhe shikim të attributeve grafike të pronave në Republikën e Kosovës. Pastaj, AKK ka zhvilluar edhe sistemin e pozicionimit KOPOS i cili mundëson matje

precize të lokacionit. AKK ka zhvilluar edhe sistemin e unifikuar të adreasve, respektivisht ka identifikuar dhe digjitalizuar mbi 22.000 rrugë dhe mbi 450.000 objekte në tërë territorin e Republikës së Kosovës, të gjitha të qasshme përmes gjeoportalit shtetëror. AKK ka zhvilluar edhe produktet e avancuara hartografike, respektivisht ka prodhuar ortofoto ndër vite, ka prodhuar hartën topografike 1:25.000 dhe atë 1.250:000, ka krijuar modelin digjital të terrenit dhe atë të sipërfaqes, etj.

Produktet e AKK-së sipas Direktivës INSPIRE :

- Adresat
- Emrat gjeografik
- Hartat topografike
- Kufijtë Administrativ
- Kufiri Shtetëror
- Lartësitë
- Ndërtesat
- Ortofoto
- Parcelat
- Rrjeti i ortofotove
- Rrjeti lartësive
- Sistemi Koordinativ Referent Kosova-Ref01
- Zonat Kadastrale

KOSOVA NË PËLLËMBË TË DORËS

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS

geoportal.rks-gov.net




SFIDAT NË IMPLEMENTIM TË IKIH DHE HAPAT E RADHËS

Shumë institucione publike në Republikën e Kosovës kanë krijuar informacione gjeohapësinore digjitale, edhe pse akoma mbetet të punohet në standardizimin dhe harmonizimin e tyre dhe me ligj të rregullohen edhe aspektet e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të këtyre të dhënave mes institucioneve përkatëse. Pos kësaj, janë bërë edhe disa hapa tjerë të rëndësishëm, respektivisht është krijuar komiteti ndërministror për administrimin e tokës dhe IKIH dhe janë implementuar projekte të rëndësishme regjionale si "INSPIRATION", "IMPULS", "SPATIAL" dhe "SPATIAL II". Këto projekte në thelb kanë pasur ngritjen e kapaciteteve profesionale në AKK në fushën e harmonizimit të të dhënave gjeohapësinore të Republikës së Kosovës me ato të shteteve anëtare të BE-së. Mirëpo, akoma kanë mbetur sfida që po pengojnë avancimin në implementim të IKIH, e të cilat kanë të bëjnë fillimisht me mungesën e akteve ligjore dhe nënligjore që

rregullojnë detyrat dhe përgjegjësitë e

institucioneve të interesit në fushën e IKIH, pastaj mungesa e të dhënave digjitale, mungesa e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale që po e pamundësojnë avancimin e qasjes në kohë reale në të dhëna digjitale, mungesa e adaptimit të standardeve për harmonizim të të dhënave e që më pas po rezultojnë me pamundësinë e ndërveprueshmërisë mes të dhënave të ndryshme, mungesa e meta të dhënave dhe pengesa në bashkëpunimin ndërinstitucional që rrjedhë nga mungesa e informacioneve mbi IKIH dhe obligimeve që Republika e Kosovës ka ndaj komunitetit evropian në këtë fushë. Ndërsa sa i përket vizionit, e ardhmja e zhvillimit të infrastrukturës së informacioneve hapësinore është e ndërlidhur ngushtë edhe me procese tjera e që kryesisht kanë të bëjnë me përfshirjen dhe me zotimet politike, respektivisht të stimulohet edhe më tej debati për IKIH midis vendimmarrësve që do të rezultonte me rritjen e koordinimit ndërinstitucional. Kjo mund të arrihet vetëm përmes imponimit të IKIH si temë e rëndësishme në agjendën poli-



tike, e cila do të kulmonte edhe me miratim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës të Ligjit për Infrastrukturën Kombëtare të Informacioneve Hapësinore. Pos aprovimet të Ligjit, e rëndësishme do të ishte edhe gjithëpërfshirja në zbatim të Ligji të IKIH, respektivisht zbatimi i detyrave dhe përgjegjësiwe ligjore nga institucionet përgjegjëse dhe nga institucionet përkrahëse dhe nga ato përfutuese, aplikimi i treguesve (indikatoreve) kryesorë të performancës për monitorimin e progresit të zbatimit të Ligjit dhe përcaktimi i rreziqeve kryesore në zbatimin e IKIH-së. Po ashtu, e rëndësishme për tu përmendur është edhe nevoja për ndërgjegjësimin e publikut, respektivisht rritja e mëtutjeshme e vetëdijes për institucionet në nivel qeveritar, sektorin privat dhe akademik, dhe ngritja e mëtutjeshme e kapaciteteve brenda institucioneve të tjera të IKIH -së. Një komponentë e rëndësishme e cila do të japë një shtytje

të madhe në avancimin e fushës së Infrastrukturës Kombëtare të Infoprmacioneve Hapësinore do të jetë e varrur edhe nga zhvillimet e IT-së, respektivisht zhvillimi i Gjeoportalit të ri Shtetëror për IKIH dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i ueb serviseve të subjekteve të tjera IKIH-së.





Agjencia Kadastrale e Kosovës

Rr. "Arbnor dhe Astrit Dehari" No. 25

10000, Prishtinë

Republika e Kosovës

038 512 353

akk@rks-gov.net

www.kca-ks.org

<http://geoportal.rks-gov.net>